



PROCESVERBAL

I pranimit teknik te perkohshem te punëve ne projektin “Asfaltimi i rrugëve Dollovë-Grabanicë-Dush-Jellovc ” Komuna e Klinës

Klinë: 17.12.2019

I përpiluar me datën, 16.12.2019 nga ana e komisionit për pranim teknik të punëve në projektin **“Asfaltimi i rrugëve Dollovë-Grabanicë-Dush-Jellovc” Komuna e Klinës** Komisioni është formuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me Vendim 06 nr351- 49183/19 të datës 16.12.2019 me këtë përbërje

1. Visar Bojaj -. kryetar
2. Ndue Sheraj –antar
3. Ali Gashi – antar

Komisioni me përbërje të plotë ka filluar me punë me 17.12.2019 në ora 9, të pranishëm ishin Menaxheri i projektit, dhe përfaqësuesi i punëkryesit.

Detyrë e komisionit për kontroll teknik është shqyrtimi i dokumentacionit investivo teknik në bazë të së cilit është ndërtuar objekti dhe shikimi i punëve të kryera në vend.

Në bazë të shikimit të dokumentacionit investivo teknik komisioni ka konstatuar :

I Të dhënat e përgjithshme

- investitor është Ministria e Zhvillimit Rajonal në Prishtinë dhe komuna e Klina
- punëkryes Konzerciumi “ Benita Company “nga Klina&Asfalt Group-shpk & Dreoni shpk nga Klina
- kontrata në mes të Komunës së Klinës dhe Konzerciumi “ Benita Company “nga Klina&Asfalt Group-shpk & Dreoni shpk nga Klina nr.055/2019 me numër protokoli 01nr.351-30587/19 e datës 19.07.2019 me vlerë 213.302,92€
- Vendimi për menaxhimin e kontatës
- Vendimi i komisionit për pranim teknik 06nr.351-49183/19 i datës 16.12.2019
- Plani dinamik 100 ditë

II Kontrolli i dokumentacionit teknik

- Projekti me paramasë dhe parallogari
- Situacionet për punët e kryera
- Ditarin ndërtimor
- Libri ndërtimor
- Testet për matjen e tamponit 0-63mm
- Testet për matjen e tamponit 0-31.5mm
- Testet e asfaltit AB16
- Data e fillimit të punëve sipas ditarit 03.09.2019
- Data e përfundimit të punëve 15.10.2019
- Fotografitë e realizuara gjatë punimeve

III Kontrolli i punëve të kryera në vend

Pas shikimit të dokumentacionit investivo -teknik ,anëtarët e komisionit në praninë e përfaqësuesit të ekzekutimit të punimeve, menaxherit të projektit dhe organit mbikëqyrës nënë shikimin në vend me qëllim të kontrollit të kualitetit të punëve të kryera, veçanërisht në aspektin e plotësimit të kërkesave themelore për ndërtim dhe me këtë rast konstatoi:

“Asfaltimi i rrugëve Dollovë-Grabanicë-Dush-Jellovc” Komuna e Klinës është ndërtuar sipas parakushteve të ofruara nga kontrata dhe projekti.

Andaj pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik investiv që pati në dispozicion komisioni, dhe pas shikimit të punëve në vend, bazuar në konstatimet e lartcekura jep këtë

PERFUNDIM

“Asfaltimi i rrugëve Dollovë-Grabanicë-Dush-Jellovc” Komuna e Klinës është ndërtuar në pajtim me dokumentacionin teknik dhe projektin . Gjatë ndërtimit janë aplikuar normativat dhe standardet e kërkuara për këtë lloji ndërtimi. Andaj bëhet pranimi teknik i perkohshëm për punët e kryera deri në kalimin e afatit garantues ku do të bëhet pranimi përfundimtar. Komisioni përfundoj me punë në ora 13,00h.

Menaxheri i projektit

Lorenc Marleku

Komisioni për pranim teknik:

1. Visar Bojaj

2. Ndue Sheraj

3. Ali Gashi